RAPORTI I SHQYRTIMIT PUBLIK
HARTIMI I HARTËS ZONALE TË KOMUNËS SË GLLOGOCIT 2021-2029

Hyrje

Ky raport përfshin Procesin e Konsultimeve gjatë hartimit të Hartës Zonale të Komunës (HZK) së Gllogocit 2021-2029. Raporti përshkruan procesin pjesëmarrës nëpër faza të ndryshme të hartimit të planit me qëllim të arritjes së konsensuzit mbi çështjet kyçe dhe me prioritetet. Konsultimet me pjesëmarrësit kanë qenë pjesë esenciale e procesit gjatë hartimit të HZK-së.
Ky raport është hartuar nga Autoriteti Përgjëgjës Komunal për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor në bashkërendim me drejtoritë sektoriale të Komunës

PROCESI PJESËMARRËS

Gjatë procesit të hartimit të HZK-së konsultimet kanë qenë mekanizëm që kanë mundësuar angazhimin kualitativ dhe efektiv të pjesëmarrësve të ndryshëm, bashkëpunim me institucionet dhe autoritetet të nivelit qendror ashtu dhe ate lokal. Duhet theksuar se përfaqësuesit nga të gjithë sektorët duke filluar nga ai publik, privat dhe nga shoqëria civile dhe me profesione të ndryshme kanë marrë pjesë aktivisht me qëllim të arritjes së zgjidhjes kolektive për sfidat zhvilllimore që i ka komuna e Gllogocit.

Gjatë këtij procesi janë themeluar Grupet Punuese mbi Çështje-Specifike (fusha tematike), të përbëra nga përfaqësues të ndryshëm të pjesëmarrësve. Procesi ka filluar me Analizë të pjesëmarrësve sipas fushave tematike dhe ka qenë proces dinamik i cili ka ndihmuar në identifikimin e legjitimitetit, interesit dhe rolit të secilit pjesëmarrës në proces të hartimit të këtij plani.

I tërë procesi pjesëmarrës ka qenë i strukturuar në disa forma të takimeve:

- Takimet fillestare
- Takimet konsultative informuese
- Punëtoritë dhe
- Prezantime
- Shqyrtimi Publik.

Takimet Fillestare

Me dt.13.04.2018 janë mbajtur takimet e para konsultative me Ekipen Komunale të Planifikimt (EKP) dhe me Ekipen e Këshilluesve të Komunitetit (EKK). Në të dy takimet ka pasur diskutime të frytshme ku është mirëpritur mjaftë me interesim iniciativa për Hartimin e PZHK-së dhe HZK-së për Komunën e Drenasit.

Takimi fillestar me EKP

Duke pasur parasysh rëndësinë e takimeve konsultative në tërë territorin e komunës së Gllogocit, zyrtarët komunal kanë informuar pjesëmarrësit paraprakisht me anë të ftesave si në vijim. Në këto takime kanë qenë prezent 175 veta që kryesisht kanë qenë banorë të komunës ku është dhënë mundësia e barabartë të gjithëve që të shprehin shqetësimet, sfidat në vendbanimet që jetojnë.

Takimi i parë konsultativë me qytetar në fshatrat Tërstenik, Vërboc, Shtuticë dhe Polluzhë është mbajtiur me 18 Qershor 2018, qëllimi I të cilit ishte të informojë qytetarët dhe të diskutohet procesi e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale të Komunës. Komuna e Gllogocit është deklaruar se pret nga qytetarët të jenë pjesëmarrës aktiv në të gjitha fazat e hartimit të dokumenteve.

Takimet informuese me 18 Qershor 2018

Me datë 19.06.2018, komuna ka vazhduar takimet konsultative në bashkësinë lokale Gllanasellë dhe në fshatrat Gllanasellë, Gradicë, Godanc, Dobroshec, Likoshan dhe Çikatovë e Vjetër.



Takimet informuese me datë 19.06.2018

Me dt.20.06.2018 në ora 17:00 janë mbajtur takimet konsultative informuese në Zabel i Ulët ku janë ftuar të gjithë banorët e fshatrave Zabel i Ulët, Korroticë e Ulët, Korroticë e Epërme, Poklek dhe Vasilevë.

Takimet kanë vazhduar me banorët e fshatrave, Gllanasellë, Dobroshec, Godanc, Gradicë, Likoshan dhe Çikatovë e Vjetër. Takimi është mbajtur në shkollën "Xhevë Lladrovci" në Gllanasellë, ku të pranishmit kanë marr informatat e para nga përfaqësuesit e Komunës për rëndësinë e këtyre dy dokumenteve strategjike të Komunës, ndërsa banorët kanë paraqitur kërkesat dhe sugjerimet e tyre lidhur më hartimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale të Komunës. Banorët janë informuar se këto dy plane financohen nga GIZ-i gjerman dhe kanë një rendësi shumë të madhe për qytetarët e Komunës së Drenasit.

Prandaj, komuna i fton qytetarët që të shfrytëzojnë të drejtën e tyre për pjesëmarrje dhe sygjerime për adresim të sfidave që ballafaqohet komuna.

Takimet informuese me dt.20.06.2018

Takimet konusltative kanë vazhduar edhe me datën 21 qershor 2018 në Komoran ku në mënyrë të njajtë është diskutuar dhe janë informar banorët për hartim të planeve dhe rëndësinë e pjesëmarrjes në proces të hartimit.

Takimet informuese me datën 21 qershor 2018

Më 22 qershor 2018 takimet konsultatve janë mbajtur në Sankoc.

Takimet informuese më 22 qershor 2018

Ndërsa me dt.25.06.2018 në ora 17:00 kanë vazhduar takimet në Arllat në shkollën Abedin Bujupi, kurse me dt.26.07.2018 në ora 17:00 në Çikatovë të Re në shkollën Ali Gashi.

Takimet informuese me dt.25.06.2018 dhe 26.07.2018

Me datën 27.06.2018 në ora 17:00 kanë vazhduar takimet në Baicë në shkollën "Migjeni" ku kanë qenë të ftuar banorët nga zonat Baicë, Damanek, Abri dhe Tërdec.

Takimet informuese 27.06.2018

Më 28 qershor 2018 janë ftuar qytetarët nga Drenasi dhe me gjerë, që të marrin pjesë në takime informuese e cila është mbajtur në Shkollën "Rasim Kiqina", në ora 17:00.

Takimet informuese më 28 qershor 2018

Vendimi i Kuvendit Komunal për hartimin e HZK-së: 19 Shtator 2017

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit(Gllogocit)
Kuvendi i Komunës

12 Nr. 353-6550 dt 31.01.2018

Në bazë të nenit 12,17 si dhe nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës"Nr. 28 qershor 2008), nenit 5. paragrafi 1.2. nenparagrafi 1.2.2. dhe nenit 10 Paragrafi 2. nenparagrafi 2.1.,neni 11., 16.dhe nenit 26 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor 04/L-174, datës 23.08.2013 si dhe Udhëzimi Administrativ MMPH –Nr.24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për Hartimin,Zbatimin dhe Monitorimin e Hartës Zonale të Komunës,si dhe nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit , Kuvendi i Komunës së Drenasit, në mbledhjen e mbajtur me datën 30.01.2018 miratoi këtë:

VENDIM

Për fillimin e procedurave për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Gllogocit

Neni 1.

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

Me këtë vendim fillohet hartimi i Hartës Zonale të Komunës së Gllogocit

Neni 2

Përkufizimi i dokumentit të planifikimit hapësinor

Me këtë vendim përkufizohet dokumenti i planifikimit hapësinor, Harta Zonale e Komunës në harmoni me ligjin përkufizohet si dokument multi-sektorial që përmes grafikoneve, fotografive, hartave dhe tekstit përcakton hollësisht llojin, destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimit të cilat bazohen në kohëzgjatje dhe projeksione të arritshme të investimeve publike dhe private për tërë territorin e Komunës, për periudhën tetë (8) vjeçare

Neni 3.

Qëllimi i hartimit

Me Hartën Zonale të Komunës nga neni 1 i këtij vendimi, përcaktohen kushtet zhvillimore dhe kushtet ndërtimore për zonat urbane dhe rurale në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale të rregullimit dhe ndërtimit në Komunën e Gllogocit, plotëson kërkesat ligjore për rregullimin e zhvillimeve në zonës urbane dhe rurale.

1

Neni 4.

Zonat Kadastrale në territorin e Komunës së Gllogocit janë :

ZONA KADASTRALE	KADASTRAL I	Sipërfaqja m²	SIP_HEKTAR
70310042	LLAPUSHNIK	15243217	1524
70310053	NEGROC	10075967	1008
70310058	ARLLAT	13125209	1313
70314016	KORROTICA EPERME	8495059	850
70314017	FUSHTICA E EPERME	4559921	456
70314018	ZABELI I EPERME	3121292	312
70314025	KORROTICA E ULET	4126284	413
70314026	FUSHTICA ULET	6135453	614
70314029	ZABEL I ULET	4517792	452
70314033	KISHNAREKA	6604842	660
70314035	KAMARAN	11291927	1129
70314053	NEKOC	10363430	1036
70314067	SANKOC	13980670	1398
70315003	BAICA	11512181	1151
70315008	VASILEVA	9663154	966
70315011	VERBOC	7998982	800
70315012	VUQAK	4589835	459
70315014	GLLANASELLA	10591245	1059
70315015	GLLOBAR	5088305	509
70315016	GLLOGOC	3722403	372
70315017	GRADICA	12261467	1226
70315019	ABRI E EPERME	12100424	1210
70315022	GODANC	3718586	372
70315023	DOBRASHEC	13033184	1303
70315024	DAMANEK	3141428	314
70315035	KRAJKOVA	7486398	749
70315044	LIKOSHAN	4564363	456
70315052	QIKATOVA E RE	5588535	559
70315056	PAKLEK	6978123	698
70315057	POLLUZHA	4183326	418
70315066	QIKATOVA E VJETER	6670048	667
70315069	TERDEVC	8402369	840
70315071	TERSTENIK	15625072	1563
70315077	SHTRUBULLOVA	2793464	279
70315078	SHTUTICA	4634736	463

2

Neni 5

Subjekti përgjegjës për hartim

Bartës i hartimit të Hartës Zonale të Komunës caktohet Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 6

Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm për hartim

Harta Zonale e Komunës hartohet në bashkëpunim me GIZ-in .
Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit koordinon procesin e hartimit të Hartës Zonale të Komunës me drejtoritë sektoriale dhe burimet njerëzore brenda komunës dhe në bashkëpunim me GIZ-in , në bazë të kontratës të lidhur me kontraktorin e përzgjedhur përmes procedurave të prokurimit publik sipas Ligjit .

Neni 7.

Afati I hartimit

Bartësi I hartimit të dokumentit të planifikimit hapësinor,sipas nenit (një)1 të këtij Propozim Vendimi është obliguar që hartën Zonale të Komunës të hartoj në afat prej pesëmbëdhjetë (15) muajve , nga dita e hyrjës në fuqi të këtij propozim Vendimi.

Neni 8

Konsultime Publike

Projekti i Hartës Zonale të Kosovës para finalizimit duhet të vihet në konsultime publike dhe në shqyrtim publik. Paraqitja e Projektit të Hartës Zonale të Komunës në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e sygjerimeve dhe komenteve do të shpallen përmes njoftimeve publike.

Neni 9

Afati i Vlefshmërisë

Harta Zonale e Komunës hartohet për periudhën kohore 8 (tetë) vjeçare

Neni 10

Gjuha zyrtare

Dokumenti i planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij vendimi duhet të jete në gjuhët zyrtare të komunës dhe së paku në 3 (kopje) të shtypura e të vulosura dhe 3 kopje digjitale të origjinalit.

Neni 11

Programi

Pjese e këtij vendimi është programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit i paraparë me nenin 11 pika 1.3. të Ligjit për Planifikimin Hapësinorë Nr. 04/L-174.

3

Neni 12

Hyrja ne fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e Miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja 15 dite pas regjistrimit në zyren e protokolit të ministrisë përgjegjse për veteqëverisje Lokale si dhe publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Kryesitesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj

Takime publike për informimin e qytetarëve për fillimin e procesit të hartimit të PZHK-së dhe HZK-së dhe kontributit të tyre: Baicë, Gllanasellë, Tërstenik, Gllogoc-qytet, Arllat, Komoran

Takimet informuese nëpër nënqendra të komunës

Takime pune të grupit punues të komunës për hartimin e HZK-së përgjatë gjithë vitit 2019 dhe 2020

Takimet dhe punëtori të grupit punues

Punëtori për trajtimin e kushteve zhvillimore/ndërtimore në HZK: 09-10 Dhjetor 2019, Prevallë;

Puntori për HZK – Prevallë

Prezantimi i draft-HZK 2021-2029 para MMPHI para se të vihet në shqyrtim publik: 13 tetor 2020;

Propozimi I project-Hartës Zonale në MMPH – pra shqyrtimit publik

Njoftim për marrjen e Vendimt për hapjen e shqyrtimit publik të projekt –"Harta Zonale e Komunës 2021-2029 Gllogoc"

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

Njësia org. / Org. Jedinica / Org. Unit: SP-02
Nr. i Faqeve / Br. Str. / No. Pages: -15-
Nr. i Prot. / Broj Prot. / Prot. No.: 2442-2/21
Data / Datum / Date: 28.06.21
PRISHTINË / A No. 1

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostorno Planiranje i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planningand Infrastructure

Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit / Departament Prostornog Planirane, Gradnje i Stanovanje /Department of Spatial Planning, Construction and Housing

DATË/A:	24.06.2021
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Flutura Avdiu, Drejtoreshë e Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtje së Mjedisit - Komuna e Gllogocit
CC:	Ramiz Lladrovci , Kryetar i Komunës së Gllogocit
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyçi, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Njoftim për marrjen e Vendimit për hapjen e shqyrtimit publik të Projekt-"Harta Zonale e Komunës 2021-2029 Gllogoc"

E nderuara znj. Avdiu,

Bazuar në Ligjin Nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor neni 11 (paragrafi 1.9, nën paragrafi 1.9.2) Komuna e Gllogocit ka dorëzuar Projekt-" Harta Zonale e Komunës 2021-2029 Gllogoc" në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me datë 21.06.2021 me numër të protokollit 2442/21, **para shqyrtimit publik** për të verifikuar përputhshmërinë me "Planin Hapësinor të Kosovës –Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010-2020+".

Sipas nenit (9 paragrafi 2 nën paragrafit 2.3), Ministria Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është përgjegjëse për vlerësimin e përputhshmërish së Projekt-"Harta Zonale e Komunës 2021-2029 Gllogoc" që është në përputhje me "Planin Hapësinor të Kosovës – Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010-2020+" dhe me Udhëzimin Administrativ MMPH-Nr.08/2017 Për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor.

Faqe1nga15

Duke u bazuar në nenin 20 të Ligjit Nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor dhe në nenin 7 të Udhëzimit Administrativ MMPH-Nr. 05/2014 për Përgjegjësit e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikim Hapësinor, Ministria nxjerr Vendim për pëlqim, që Kuvendi i Komunës së Gllogocit sipas procedurës për Përgjegjësitë e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikim Hapësinor, **Mund të bëjë Hapjen e Shqyrtimit Publik.**

Vëmendje:
Në kuadër të shkresës të bashkangjitur gjeni komente dhe sugjerimet e veçanta të Projekt-"Harta Zonale e Komunës 2021-2029 Gllogoc", të cilat Duhet të plotësohen nga Autoriteti Përgjegjës Komunal për Planifikim dhe menaxhim hapësinor, gjatë hapjes së shqyrtimit publik.

Me respekt,

Faqe2nga15

Komente të përgjithshme

1. Pjesa tekstuale dhe pjesa hartografike e Projekt-Harta Zonale e Komunës të hartohet në harmoni të plotë me dispozitat ligjore të U.A MMPH Nr. 24/2015; U.A MMPH Nr. 08/2017 kap. I (neni 1 dhe 2 HILUCS ,neni 3 KHRRP/HSRLC dhe neni 4.) dhe U.A. QRS Nr. 03/2019 (neni 16 , Shtojca 05 dhe Shtojca 06).

2. Kushtet zhvillimore për secilën zonë duhet të jenë të hartuara sipas dispozitave ligjore dhe të përcaktuara në bazë të kërkesave të U. A. MMPH-NR. 24/2015, neni 12, duke përfshirë paragrafin 4.; 6 (nen paragrafët 6.7) dhe paragrafin 7.

3. Bonuset e zonimit duhet të jenë brenda NTPH, respektivisht Kushteve zhvillimore dhe Kushtet ndërtimore duke përfshirë indekset e shfrytëzimit sipas neni 39 te U. A. MMPH-NR. 24/2015. të epen kritere të qarta dhe zgjidhje të mençura të bazuar në analiza të profesionale dhe të dhëna të sakta për lejimin e tyre, gjithnjë brenda normativës së lejuar –të përfshihet edhe paragrafi 2. I nenit 39.

4. Plotësimet dhe ndryshimet e kërkuara në pjesën tekstuale të përcillen në pjesën hartografike.

Pjesa tekstuale

1. **Faqe 18-** *" brinja nga e cila parcela ka qasje në rrugë përmes servitutit."*
   Koment:
   Shprehja "servitut" të përdoret sipas U.A. MMPH Nr. 08/2017 kap. I neni 3. Shiko përkufizimin e servituteve në cilat rate mund të përdoren.
   Nuk është marrë parasysh sipas kërkesave ligjore!

2. **Faqe 44** *" 4.Lista e Zonave; 4.1. Lista e të gjitha zonave dhe zonave Mbishtresore-Tabela"*
   Koment:
   Tabela me Listëtë zonave të plotësohet në bazë të U.A. MMPH Nr. 08/2017 Kap. I neni 4 ndërsa paraqitja grafike sipas kapitulli V, pika 38.
   Lista 4.1. të jetë Listë e të gjitha zonave në komunë dhe të fshihet "Zonave mbishtresore" sepse janë paraqitur në tabelë të veçantë në faqen 45.
   Në tabelë janë paraqitur 3 nënzona për zonën e banimit, ndërsa për zonat e tjera janë paraqitur vetëm zonat primare.
   Tabela duhet të plotësohet me nënzona në bazë të U.A. MMPH Nr. 08/2017 Kap. I neni 4, neni 2 dhe Kap. IV normat sektoriale.
   Të gjitha këto plotësime të reflektohen në pjesën hartografike.
   Paraqitja grafike e zonave dhe e nënzovave tëhartohet në bazë të U.A. MMPH Nr. 08/2017 Kap. V.

   Sqarim
   Për përpilimin e tabëlës me listën e zonave sipas U.A. MMPH Nr. 24/2015 neni 11 paragrafi 3 duhet të përmblidhen të gjitha shfryëzimet e tokës në kuadër të zonës. Duke u bazuar në nenin 4 të kap. I të U.A. MMPH Nr. 08/2017 , me këtë rast paraqitet nevoja e krijimit të nënzonave të cilat duhet të jenë pjesë e kësaj tabele.
   Në përcaktimin e nënzonave do të varen edhe Kushtet zhvillimore duke përfshirë Kushtet Ndërtimore në zonë të cilat do të ndikohen nga struktura që planifikohen të ndërohen në sipërfaqen e zonës të cilat do të përcaktohen në bazë të U.A. MMPH Nr. 08/2017 Kap. IV neni 1. Komuna me PZHK në bazë të intensitetit të zhvillimit ka

   përcaktuar densitetet në kuadër të vendbanimit, ndërsa me HZK do të bëjë dallimin e sipërfaqeve në kuadër të vendbanimit sipas shfrytëzimit dhe intensitetit që do të reflektoj me krijimin e nënzonave.
   Duhet pasur kujdes sidomos në përcaktimn e nënzonave të banimit , që ndikohen varësisht nga dendësia e banimit sipas dispozitave ligjore të dhëna me të U.A. MMPH Nr. 08/2017 Kap. IV neni 2 duke definuar sipërfaqet sipas shembujve të dhënë .

Faqe3nga15

3. **Faqe 44**.- *"Tabela 4. Strukturat e ndërtuara të kategorizuara sipas dendësisë"*
Koment:
Të paraqiten nënzonat (nëse ka ndryshime të intensitetit, kushteve , etj brenda zonës) në kuadër të zonave primare. Kjo tabelëështë pjesë e PZHK.
Nuk është plotësuar komenti. Të plotësohet!

4. **Faqe 45-"***4.lista e zonave , 4.2. Zonat mbishtresore"*
Të ndryshohen paraqitja hartografike e zonave mbishtresore. Tabela me Listë të zonave mbishtresore të plotësohet në bazë të U.A. MMPH Nr. 08/2017 Kap. I neni 4 ndërsa paraqitja grafike sipas kapitulli V, pika 38 .

5. **Faqe 45,47,48**.- *" Harta 1,2,3,4,5 dhe 6"*
Koment:
"Harta 4- Harta zonale e shfrytëzimit të tokës të HZK "**duhet të plotësohet** duke i përfshi të gjitha zonat dhe nënzonat në komunë që janë të parapara me këtë hartë zonale të komunës. Shfrytëzimet e zonës duhet të jenë në bazë të nomoglaturës HILUCS dhe KHRRP nga U.A. MMPH Nr. 08/2017 Kap I neni 2 dhe 3 dhe U.A. (QRK) NR. 03/2019 , neni 16 dhe Shtojca 5 dhe 6.
Nuk është plotësuar komenti. Të plotësohet!

6. **Faqe 49- "***5.1. Zona pyjore- Shfrytëzimi i tokës-, Harta 7"*
Koment:

Pjesa tekstuale dhe pjesa hartografike e Projekt-Harta Zonale e Komunës të hartohet në harmoni të plotë me dispozitat ligjore të U.A MMPH Nr. 24/2015; U.A MMPH Nr. 08/2017 kap. I (neni 1 dhe 2 HILUCS dhe neni 3 KHRRP/HSRLC) dhe U.A. QRS Nr. 03/2019 (neni 16 , Shtojca 05 dhe Shtojca 06)duke paraqitur të gjitha nënzonat .
Pjesa tekstuale dhe pjesa hartografike të jetë në harmoni me U.A MMPH Nr. 08/2017 kap. II neni 2, ndërsa "Ndërtesat mbështetëse" të jenë në harmoni me nen-paragrafi 2.3.

Nuk mund të ketë struktura të ndërtuara në zonat pyjore, vetëm në rastet kur me Planin Zhvillimor Komunal është përcaktuar si zonë rekreative-turistike (shiko Kap 1 neni 2 HILUSC –KLASA 1.2). që mund të ketë të paraparë nën-zona me banimit të përhershëm apo të përkohshëm apo shfrytëzim tjetër përcjellës. Në këtë rat kushtet zhvillimore për strukturat e ndërtuara në këto zona duhet të kenë për bazë shembujt e dhënë me nenin 1 të kapitullit IV.
Të rishikohen dhe harmonizohen shfrytëzimet dytësore, shfrytëzimet e përkohshme, Kushtet zhvillimore,
Nuk është plotësuar komenti. Të plotësohet!

7. **Faqe 51.-** *"Harta 8. Harta me sipërfaqe të pyjeve , resurseve sipërfaqësore dhe nëntokësore...."*
Koment:
Pjesa tekstuale dhe pjesa hartografike e Projekt-Harta Zonale e Komunës të hartohet në harmoni të plotë me dispozitat ligjore të U.A MMPH Nr. 24/2015; U.A MMPH Nr. 08/2017 kap. I (neni 1 dhe 2 HILUCS dhe neni 3 KHRRP/HSRLC; Kap. II neni 2) dhe U.A. QRS Nr. 03/2019 (neni 16 , Shtojca 05 dhe Shtojca 06). Nënzonat që do të përcaktohen sipas shfrytëzimit dhe Kushteve zhvillimore përfshirë Kushtet ndërtimore dhe masat të paraqiten edhe në pjesën hartografike.
Nuk është plotësuar komenti. Të plotësohet!

8. **Faqe 51- "***5.2. Zona bujqësore për konsum privat dhe tregtar- Shfrytëzimi i tokës"*
Koment:
Pjesa tekstuale dhe pjesa hartografike e Projekt-Harta Zonale e Komunës të hartohet në harmoni të plotë me dispozitat ligjore të U.A MMPH Nr. 24/2015; U.A MMPH Nr. 08/2017 kap. I (neni 1 dhe 2 HILUCS-Klasa 1.1.; dhe neni 3 KHRRP/HSRLC; Kap II neni 1) dhe U.A. QRS Nr. 03/2019 (neni 16 , Shtojca 05 dhe Shtojca 06) .

Faqe4nga15

Duke pas parasysh që koncepti i zoonimit është pjesë e shfrytëzimit të tokës dhe duke u mbështetur në funksionin e zonës -në bazë të KHRRP dhe projeksionet e dala nga PZHK bëhet klasifikimi i shfrytëzimit të tokës sipas nomenklaturës së HILUCS si: prodhimit parësor, dytësor, tretësor, banim, rrjete të transportit apo logjistike , infrastrukturë publike, banim apo shfrytëzim tjetër. Në bazë të këtyre shfrytëzimeve përcaktohet se çfarë lejohet , ndalohet, apo lejohet më kushte të caktuara të zhvillohet në zonë.
Me qëllim të rregullimit të intensitetit të zhvillimit të zonave si në zonën urbane po astu dhe në zonën rurale përdoren Vlerat e rekomanduara për planifikim të strukturave të ndërtuara në zona dhe nën-zona , duke pas për bazë shembujt e dhënë me nenin 1 dhe 2të kapitullit IV dhe normat e tjera sektoriale.
Në rast se nuk përcillen hapat ligjor sipas U.A. që u munduam të përshkruaj në këtë tekst , mund të lëshohen gabime në rregullim dhe shfrytëzim të hapësirës.
Nënzonat që do të përcaktohen sipas shfrytëzimit dhe Kushteve zhvillimore përfshirë Kushtet ndërtimore dhe masat të paraqiten edhe në pjesën hartografike.
Nuk është marrë parasysh kërkesa ligjore.

9. **Faqe 54 -***"5.3. Zona rekreative dhe Harta 10"*
Koment:
Pjesa tekstuale dhe pjesa hartografike e Projekt-Harta Zonale e Komunës të hartohet në harmoni të plotë me dispozitat ligjore të U.A MMPH Nr. 24/2015; U.A MMPH Nr. 08/2017 kap. I (neni 1 dhe 2 HILUCS dhe neni 3 KHRRP/HSRLC) , Kap. IV (neni 1, 2,8) dhe U.A. QRS Nr. 03/2019 (neni 16 , Shtojca 05 dhe Shtojca 06).

Të epen Kushte zhvillimore për të gjitha shfrytëzimet të bazuara në Normat teknike të Planifikimit Hapësinorë, si për shfrytëzime të lejuara, dytësore apo të veçanta , p.sh. *" Shfrytëzimet e lejuara te veçanta: Shërbim i komunitetit: Shërbim shëndetësor dhe rekreativ".*
Të epen Kushtet zhvillimore duke përfshirë Kushtet ndërtimore (duke pas për bazë kërkesat ligjore të nenit 21 të Ligjin Nr. 04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor) për struktura të ndërtuara po ashtu edhe për strukturat dhe hapësirat tjera të pa mbuluara.

Nënzonat që do të përcaktohen sipas shfrytëzimit dhe Kushteve zhvillimore përfshirë Kushtet ndërtimore dhe masat të paraqiten edhe në pjesën hartografike.
Zona turistike dhe rekreative. Nuk është bërë plotësimi .
Të trajtohet kërkesa dhe të bëhet plotësimi.
Të plotësohet me bazë ligjore në që ka shërbyer për përcaktimin e elementeve të rregullimit në tabelën në faqe 56!
Nuk është marrë parasysh kërkesa ligjore.

10. **Faqe 54 –"***5.4. Zona komerciale dhe industriale (ZKI) dhe harta 11"*
Koment:
Pjesa tekstuale dhe pjesa hartografike e Projekt-Harta Zonale e Komunës të hartohet në harmoni të plotë me dispozitat ligjore të U.A MMPH Nr. 24/2015; U.A MMPH Nr. 08/2017 kap. I (neni 1 dhe 2 HILUCS dhe neni 3 KHRRP/HSRLC) , Kap. IV dhe U.A. QRS Nr. 03/2019 (neni 16 , Shtojca 05 dhe Shtojca 06).
Të epen Kushtet zhvillimore duke përfshirë Kushtet ndërtimore (duke pas për bazë kërkesat ligjore të nenit 21 të Ligjin Nr. 04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor) për struktura të ndërtuara po ashtu edhe për strukturat dhe hapësirat tjera të pa mbuluara.

Nënzonat që do të përcaktohen sipas shfrytëzimit dhe Kushteve zhvillimore përfshirë Kushtet ndërtimore dhe masat të paraqiten edhe në pjesën hartografike.
Legjenda e hartës 11 është e palexueshme. Të epet një formë e qartë për lexim.
Nuk është marrë parasysh kërkesa ligjore.

11. **Faqe 59.-***"Harta 1: harta me sipërfaqe ekzistuese dhe të planifikuara për aktivitete ekonomike –Kushtet Zhvillimore"*

Faqe5nga15

Koment:
Të plotësohet sipas neni 3 KHRRP/HSRLC dhe U.A. QRS Nr. 03/2019 (neni 16 , Shtojca 05 dhe Shtojca 06). Nënzonat që do të përcaktohen sipas shfrytëzimit dhe Kushteve zhvillimore përfshirë Kushtet ndërtimore dhe masat të paraqiten edhe në pjesën hartografike.
Nuk është marrë parasysh kërkesa ligjore.

12. **Faqe 58,59,60-** " *5.5.1. Lumenjtë Drenica & Vërboci;*
Koment:
Shfrytëzimet në zonë , Kushtet Zhvillimore dhe masat mbrojtëse zona duhet të jenë në harmoni të plotë me Ligjet dhe aktet nënligjore për mbrojtjen e ujërave në Kosovë dhe U.A. MMPH Nr. 08/2017 NTPH kap. I neni 1 ,2 dhe 3 ; dhe kap. II neni 3. Andaj çdo shfrytëzim i lejuar apo me kushte të veçanta duhet të përcaktohet me NTPH.
Nuk është marrë parasysh kërkesa për plotësim dhe ndryshim sipas kërkesave ligjore.

13. **28.Faqe 73- "***TABELA- kushtet zhvillimore për zonat ZP, ZB-KPT, ZR, ZKI, ZT, SU, ZMS & ZRM"*
Koment:
Kushtet zhvillimore të zonave të hartohet në bazë të dispozitave ligjore të dhëna me nenin 12 tëU. A. MMPH-NR. 24/2015 dhe U.A. MMPH Nr. 08/2017 NTPH kap. IV , duke përfshirë intensitetet e zhvillimit të zonave, sipërfaqet që trajtohen, densitetet , normat sektoriale, duke përfshirë kushtet ndërtimore dhe masat mbrojtëse dhe dispozitat rregulluese dhe kufizuese që dalin nga ligjet përkatëse.

Në rast se zona dhe nënzona nuk ka të dhënë sipërfaqen, numrin e banorëve dhe dendësinë e banorëve për hektar andaj Projekt- Harta Zonale e Komunës së Gllogocit nuk mund të vlerësohet, me qenë se nuk ka të definuar treguesit si janë të paraparë me bazën ligjore.
Vlen për të gjitha zonat !

Zonat e banimit të hartohen në harmoni me U.A. MMPH Nr. 08/2017 NTPH (Kap. I HILUCS dhe KHRRP, dhe Kap. IV) dhe U.A. QRS Nr. 03/2019 (neni 16 dhe Shtojca 05 , Shtojca 06).
Banimi- Të klasifikohet banimi si Banim i përhershëm (banim ferme, shtëpi të veçanta, dyshe, banim shumëfamiljar apo tjetër), banim me funksione të tjera në përputhshmëri (banim shumëfamiljar/ shërbime komerciale; shërbime financiare; Industria e prodhimtarisë së lehtë; apo tjetër), Banim tjetër (kamping, banim i përkohshëm individual, banim i përkohshëm shumëfamiljar dhe tjetër).
Kushtet zhvillimore në bazë të U.A.MMPH Nr. 24/2015 neni 12.,duhet të kontrollojnë vendndodhjen, intensitetin , densitetin dhe karakterin e zhvillimit.
Nuk është marrë parasysh kërkesa për plotësim dhe ndryshim sipas kërkesave ligjore.

14. **Faqe 78-** "*5.9. Zonë banimi me dendësi të mesme(ZBUM-U)-Shfrytëzimi i tokës-…dhe ndërtesa me shumë njësi. …."*
Koment:
Sipas dendësisë banimore në nën-zonë**nuk lejohet ndërtesa me shumë për dendësi deri në 188 banorë në hektar.** Të ndryshohet (shiko U.A. MMPH Nr. 08/2017 Kap IV neni 2 dhe U.A. QRS Nr. 03/2019 neni 16 dhe Shtojca 05, Shtojca 06).
Kushtet zhvillimore dhe madhësia e parcelës kadastrale për zhvillim të harmonizohen sipas ndryshimeve të kërkuara lidhur me përcaktimin e llojit të ndërtesave duke marrë parasysh dendësinë banimore.
Nuk është marrë parasysh kërkesa për plotësim dhe ndryshim sipas kërkesave ligjore.

15. **Faqe 84-** Tabela *kushtet zhvillimore për zonat ZBUSH-R, ZBU-R, ZBM-U & ZBL-U"*
Koment:
Kushtet zhvillimore të zonave të hartohen sipas nenin 12 të U. A. MMPH-NR. 24/2015 dhe U.A. MMPH-NR. 08/2017 Kap. 4 neni 1.

Përcaktimi i madhësisë së parcelës për llojin e ndërtesave të banimit me një njësi por edhe me shumë njësi, apo edhe te ndërtesat e tjera në zonat komerciale, ekonomike, etj., duhet të jenë në harmoni me MMPH-Nr. 08/2017 NTPH Kap. IV neni 2 dhe U.A. QRS Nr. 03/2019 (neni 16 dhe Shtojca 05, Shtojca 06) , ku varësisht nga densiteti i zonës përcaktohet edhe lloji i lejuar i ndërtesave që është indikator për dimensionet e parcelës kadastrale për zhvillim (shiko nenin 21 të Ligjit Nr. 04/L-174)

Nuk është marrë parasysh kërkesa për plotësim dhe ndryshim sipas kërkesave ligjore.

Të trajtohet sipas kërkesës ligjore

Faqe 86 – "Tabela *KUSHTET ZHVILLIMORE PER ZONAT ZBSHU-R, ZBU-R, ZBM-U & ZBL-U"*

ZONAT	SHFRYTEZIMET E LEJUARA	MADHËSIA AE PARCELËS [I]	FRONTI [II]	ISN [III]	ISHPKZH [IV]	SGJP [V]	SNP [VI]		VN [VII]	VNN [VIII]	DISTANCAI [IX]	DISTANCA II [X]	DISTANCA III [XI]	
ZBSHU-R	Shtëpi të veçanta	4 - 10 ari	4m	0.6	40%+10% pllakosje	50%	40%		7m	7m	0.5 H	0.25H	Ndërtesa mund te ndërtohet deri ne kufi te parcelës me kushti qe pronaret fqinje arrijne marrevesjje te ndërsjelle te vërtetuar nga Noter Zyrtar	15 Njësi 0-70 ban / ha Lejohet vetëm banim ferme! Kushtet zhvillimore të jenë në hamoni me shfrytëzimet
	Shtëpi dyshe	5 - 8 ari	6m		50%+10% pllakosje	40%	50%							
	Shtëpi në varg	1.5 - 5 ari	3m		60%+10% pllakosje	30%	60%							
	Banim tjetër	1.5 - 5 ari	10m	0,6	30%	60%	-		10m	7m	1H	0.5H		
	Shërbim tregtar	1.5 - 10 ari	10m	0.7	40%	40%	40%		7m	7m	0.5 H	0.2H		
	Shërbim kulturor	1.5 - 10 ari	10m	0.5	30%	40%	40%		7m	7m	0.5 H	0.2H		
	Shërbim financiar	1.5 - 5 ari	15m	1	40%	40%	40%		7m	7m	0.5 H	0.2H		
	Infrastrukturë bujqësore	2 - 20 ari	20m	0.8	50%	40%	40%		7m	7m	0.7 5H	0.4H		
ZBU-R	Shtëpi të veçanta	3 - 7 ari	4m	1	40%+10% pllakosje	30%	40%		7m	7m	0.5 H	0.25H		15-25 njësi 71-117 ban/ha Lejohet shtëpi e veçantë dhe shtëpi dyshe Kushtet zhvillimore të jenë në hamoni me shfrytëzimet
	Shtëpi dyshe	4 - 6 ari	6m		50%+10% pllakosje	40%	50%							
	Shtëpi në varg	2 - 5 ari	3m		50%+10% pllakosje	40%	50%							
	Banim tjetër	1.5 - 5 ari	10m	0,6	30%	60%	-		10	7m	1H	0.5H		
	Shërbim tregtar	2 - 20 ari	10m	0.7	40%	40%	40%		7m	7m	0.5 H	0.2H		
	Shërbim kulturor	3 - 20 ari	15m	0.5	30%	40%	40%		7m	7m	0.5 H	0.2H		
	Shërbim financiar	3 - 10 ari	20m	1	40%	40%	40%		7m	7m	0.5 H	0.2H		
ZBM-U	Shtëpi të veçanta	4 - 6 ari	4m	1	40%+10% pllakosje	30%	40%		7m	7m	0.5 H	0.25H		26-40 njësi 118-188 ban/ha Lejohet shtëpi e veçantë, dyshe dhe në varg. Nuk lejohet banim shumëfamilj ar! Kushtet zhvillimore të jenë në hamoni me shfrytëzimet
	Shtëpi dyshe	4 - 6 ari	6m		50%+10% pllakosje	40%	50%							
	Shtëpi në varg	2 - 5 ari	3m		50%+10% pllakosje	40%	50%							
	Ndërtesa me shumë njësi*	10 ari +	15m	3.5	40%	40%	60%		10m	10 m	0.5 H	0.2H		
	Shërbim tregtar	3 - 5 ari	10m	1	40%	40%	40%		7m	7m	0.5 H	0.2H		
	Shërbim kulturor	3 - 5 ari	15m		30%	40%	40%		7m	7m	0.5 H	0.2H		
	Shërbim financiar	3 - 5 ari	20m		40%	40%	40%		7m	7m	0.5 H	0.2H		

Faqe7nga15

ZONAT	SHFRYTEZIMET E LEJUARA	MADHËSIA E PARCELËS I	FRONTI II	ISN III	ISHPKZH IV	SGJP V	SNP VI		VN VII	VNN VIII	DISTANCA I IX	DISTANCA II X	DISTANCA III XI	
ZBL-U	Ndërtesa me shumë njësi*	20 ari +	20m	5	60% B+P+1 40% Kati 2+	40%	35%		10m	10 m	0.5 H	0.2H		40 njësi 189-282 ban/ha Dendësia të jetë optimale
	Shërbim tregtar	5 ari +	10m	2.4	40%	40%	40%		7m	7m	0.5 H	0.2H		
	Shërbim kulturor	5 ari +	15m		40%	40%	40%		7m	7m	0.5 H	0.2H		
	Shërbim financiar	5 ari +	15m		40%	40%	40%		7m	7m	0.5 H	0.2H		
	Shërbim komunitetin	5 ari +	15m		40%	40%	40%		7m	7m	0.5 H	0.2H		

Nuk është marrë parasysh kërkesa për plotësim dhe ndryshim sipas kërkesave ligjore.
Të trajtohet sipas kërkesës ligjore.
Të harmonizohet pjesa tabelare me pjesën tekstuale.

16. **Faqe 88- "***6. Kushtet zhvillimore për shfrytëzimet e veçanta-Shfrytëzim i veçantë: Shtëpi malore-Kushtet zhvillimore: Madhësia* ***1.5 deri*** *5 ari; Fronti 10m; ISN 0.6; ISHPKZH 30%; SGJP 60%; VN 10m; VNN 7m;• Distanca 1H"*
Koment:
Shfrytëzimet në zonë dhe Kushtet zhvillimore të hartohen në bazë të U.A. MMPH Nr. 08/2017 NTPH në tërësi, e veçanërisht me kap. IV-Normat sektoriale dhe U.A. QRS Nr. 03/2019 (neni 16 dhe Shtojca 05 , Shtojca 06).
Nuk është marrë parasysh kërkesa për plotësim dhe ndryshim sipas kërkesave ligjore.
Të trajtohet sipas kërkesës ligjore.

17. **Faqe 93**
7. ZONAT MBISHTRESORE DHE KUSHTET ZHVILLIMORE
Koment:
Të plotësohet projekt- HZK me Kushte zhvillimore me U.A. MMPH-NR. 24/2015, neni 13.
Të trajtohet sipas kërkesës ligjor.

18. **Faqe 113-"** *Harta 20"*
Koment:
Si zonë mbishtresore në Komunën e Gllogocit duhet të konsiderohet Zona e Aeroporti bujqësor , dhe në afërsi të epen kushte shtesë bazuar në legjislacionin në fuqi, sidomos në kufizim të lartësisë së objektev.
Nuk është marrë parasysh kërkesa për plotësim dhe ndryshim sipas kërkesave ligjore.

19. **Faqe 122-"***8. Infrastruktura rrugore"*
Koment:
Fusha të trajtohet në tërësi dhe hollësisht në bazë të kërkesave ligjore të Ligjit Nr. 04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor neni 16 dhe nenit 14 të U.A. MMPH 24/2015.

Dispozitat rregulluese të infrastrukturës rrugore të nivelit kombëtar apo lokal të jenë konkrete për infrastrukturën që tangjenton, kalon apo është brenda komunës së Gllogocit. Rregullat të jenë konkrete për secilën pjesë e jo vetëm përshkrim nga U.A. 08/2017 NTPH.

Të plotësohet me elemente sipas kërkesave të U. A. MMPH-NR. 24/2015 neni 14, dhe të jetë e llogaritur, konkrete për secilin element të infrastrukturës rrugore, ashtu siç është e parapara në Planin Zhvillimor Komunal të Gllogocit dhe në harmoni me U.A. MMPH-NR. 08/2017, kap. 4 neni 11.

Faqe8nga15

"Procesi i propozimit dhe kategorizimit te rrugëve të reja duhet të përcjell hapet si më poshtë:"
Koment:
Kjo pjesë duhet të jetë në harmoni me U.A. MMPH 24/2015 neni 14 paragrafi 2., ndërsa *"proceset e propozimeve"* duhet të ç vendosen te pjesa e zbatimit të Projekt –"Harta Zonale e Komunës së Gllogocit! Infrastrukturës rrugore ti shtohen "Sipërfaqet publike për vend-parkim" në bazë të kërkesave ligjore të dala nga U.A. MMPH 24/2015 neni 14 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.5.
Nuk është marrë parasysh kërkesa për plotësim dhe ndryshim sipas kërkesave ligjore.

20. **Faqe 129-**" *Transporti publik*"
Koment:
Pjesa të plotësohet me kërkesat ligjore të U.A. MMPH 24/2015 neni 14 paragrafi 1 (nen paragrafi 1.1.; 1.4. 1.5) dhe paragrafi 2.
Nuk është marrë parasysh kërkesa për plotësim dhe ndryshim sipas kërkesave ligjore. Pjesa të plotësohet me kushtet teknike.

21. **Faqe 130 -***9. "Infrastruktura publike dhe sociale"*
Koment:
Të hartohet sipas kërkesave ligjore të U.A. MMPH 24/2015 neni 15 paragrafi 1 dhe të jetë e llogaritur, konkrete për secilin element të infrastrukturës *publike dhe sociale* , ashtu siç është e parapara në Planin Zhvillimor Komunal të Gllogocit dhe në harmoni me U.A. MMPH-NR. 08/2017, kap. 4 . Kushtet në zonë të jenë sa më specifike e jo të përgjithësuara dhe përshkruese të NTPH-ve.
Duke u bazuar në planet zhvillimore sektoriale dhe duke marrë parasysh gjendjen ekzistuese planifikohet infrastruktura publike dhe sociale duke specifikuar lloji, lokacionin, kapacitetin dhe kushtet teknike për projektim dhe ndërtim. Si është paraqitur në Projekt-HZK të Gllogocit janë vetëm dispozita ligjore të marra nga U.A. 08/2017 NTPH, pa specifikuar vendndodhje, sipërfaqe të nevojshme, kapacitet në bazë të numrit të banorëve për zonë, etj. Fushat duhet të hartohen duke përvetësuar nomenklaturën HILUCS dhe KHPRR Të plotësohet

9.1. Parqet publike dhe hapësirat e hapura- të specifikohet lloji lokacioni, , kapaciteti, kushtet teknike për projektim dhe ndërtim. (jo vetëm përshkrim nga PZHK dhe NTPH.
Kërkesat për parqe publike janë në kuadër të lagjes/vendbanimit, etj , ndërsa parqet rekreative në kuadër të komunës nuk llogaritën për këto kërkesa, andaj të përcaktohen!
Më HZK nuk mund të parashihet ndërtimi i palestrës sportive, pishinës,fushave të futbollit, etj , vetëm në rastin ku këto janë të përcaktuara në PZHK, dhe me HZK përcaktohen shfrytëzimet dhe Kushtet zhvillimore.-të ndryshohet!
*9.2. Fushat sportive dhe rekre*ative- të specifikohet lloji lokacioni, kapaciteti, kushtet teknike për projektim dhe ndërtim
*9.3. Hapësirat dhe ndërtimet e shërbiomeve mjekësor*e- të specifikohet lloji lokacioni, kapaciteti, kushtet teknike për projektim dhe ndërtim. (jo vetëm përshkrim nga PZHK dhe NTPH)
9.4. Ndërtesat për shërbime sociale- të specifikohet lloji lokacioni, kapaciteti, kushtet teknike për projektim dhe ndërtim. (jo vetëm përshkrim nga PZHK dhe NTPH)

ii)*Institucionet e* ***mirëqenies sociale-*** të specifikohet lloji lokacioni, kapaciteti, kushtet teknike për projektim dhe ndërtim.
iii) Objektet e religjionit- të specifikohet lloji lokacioni, kapaciteti, kushtet teknike për projektim dhe ndërtim.
9.5. Ndërtesat e institucioneve parashkollore- të specifikohet lloji lokacioni, kapaciteti, kushtet teknike për projektim dhe ndërtim. (jo vetëm përshkrim nga PZHK dhe NTPH)
9.6. Shkollat dhe universitetet- të specifikohet lloji lokacioni, kapaciteti, kushtet teknike për projektim dhe ndërtim. (jo vetëm përshkrim nga PZHK dhe NTPH)
9.7. Qendrat administrative- të specifikohet lloji lokacioni, kapaciteti, kushtet teknike për projektim dhe ndërtim. (jo vetëm përshkrim nga PZHK dhe NTPH)

Faqe9nga15

9.8. Hapësirat dhe ndërtesat e sigurisë publike- të specifikohet lloji lokacioni, kapaciteti, kushtet teknike për projektim dhe ndërtim. (jo vetëm përshkrim nga PZHK dhe NTPH)
9.9. Varrezat- të specifikohet lokacioni, kapaciteti, kushtet teknike për projektim dhe ndërtim. (jo vetëm përshkrim nga PZHK dhe NTPH)
Koment-
Komuna e Gllogocit duhet të ketë të qartë që me Hartën Zonale të Komunë do të përgatisë dokumentacionin teknik për lëshimin e Kushteve ndërtimore që do të i paraptrinjë Lejes ndërtimore. Andaj të gjitha këto plotrësime që janë kërkyuar sipas dispozitave ligjore do të mundësojnë këtë procedurë, në rast tjetër autoriteti përgjegjës komunal për menaxhim dhe planifikim nuk mund të lëshoj leje ndërtimore me Hartën Zonale të Komunës . Ashtu si janë shkruar dispozitat në këtë pjesë duhet të jenë pjesë të PZHK , ndërsa normativa të përdoret për plotësimin e këtyre kërkesave e jo vetëm të përshkruhet nga U.A. MMPH Nr. 08/2017.
Nuk është marrë parasysh kërkesa për plotësim dhe ndryshim sipas kërkesave ligjore.

22. **Faqe 140-***"10. Infrastruktura teknike"*
Koment:
Të hartohet sipas kërkesave ligjore të U.A. MMPH 24/2015 neni 16 paragrafi 1, duke u bazuar në planet zhvillimore sektoriale dhe duke marrë parasysh gjendjen ekzistuese planifikohet infrastruktura teknike duke specifikuar kapacitetin, shtrirjen e rrjeteve , ndërtesat përcjellëse, shiritat mbrojtës dhe pajisjet. Si është paraqitur në Projekt-HZK të Gllogocit janë vetëm dispozita ligjore të marra nga U.A. 08/2017 NTPH. Fushat duhet të hartohen duke përvetësuar nomenklaturën HILUCS dhe KHPRR.
Të plotësohet duke specifikuar lokacionin, kapacitetin, kushtet teknike për projektim dhe ndërtim, e jo vetëm përshkrim nga PZHK dhe NTPH.
Nuk është marrë parasysh kërkesa për plotësim dhe ndryshim sipas kërkesave ligjore.

23. **Faqe 145-***"11. Trajtimi i vendbanimeve joformale -HZK rekomandon që VJF të trajton në përputhje mekushtet zhvillimore dhe masat të përcaktuara me zonë të banimit dhe zonat tjerat relevante"*
Koment:
Kushtet zhvillimore duhet të jenë specifike për vendbanimet joformale ,duke dhënë zgjidhje të qëndrueshme të zhvillimit dhe rregullimit, ndërsa në këtë Projekt-HZK janë dhënë në formë të rekomandimeve. Të trajtohet në bazë të Ligjit Nr. 04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor neni 16 dhe nenit 17 të U.A. MMPH 24/2015. Harta Zonale nuk rekomandon, por përcakton kushte zhvillimore për secilën zonë. Trajtimi i VBJ në HZK është obligim ligjor , shiko Ligjin Nr. 04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor, neni 15. Paragrafi 2. Nën-paragrafi 2.7.
Nuk është marrë parasysh kërkesa për plotësim dhe ndryshim sipas kërkesave ligjore. Teksti nga "*Të kufizohen emetimet e pluhurit, përmes pastrimit të rregullt të zonës punuese, rrugëve, automjeteve dhe makinerive, si dhe spërkatjen me ujë të vendpunishtes dhe/ose të mbrohet nga era (p.sh. përmes mbrojtësve të erës)"……* ***dhe teksti me poshtë,*** **nuk kanë të bëjnë me fushën që trajtohet.**

24. **Faqe 163-** "*14.4. Bonuset e zonimit"*
Koment:
Bonuset e zonimit duhet të jenë Brenda Normave teknike të planifikimit hapësinor!
Nuk është marrë parasysh kërkesa për plotësim dhe ndryshim sipas kërkesave ligjore.

Faqe10nga15

Pjesa hartografike

1. Projekt-Harta Zonale e Komunës të hartohet në harmoni të plotë me dispozitat ligjore të U.A MMPH Nr. 24/2015; U.A MMPH Nr. 08/2017 kap. I (neni 1 dhe 2 HILUCS dhe neni 3 KHRRP/HSRLC) dhe U.A. QRS Nr. 03/2019 (neni 16 , Shtojca 05 dhe Shtojca 06).

2. Të paraqiten zonat dhe nën zonat sipas U.A MMPH Nr. 08/2017 kap. I neni 4.

3. Të paraqitet harta bazë sipas nenit 24 të U.A. MMPH Nr. 24/2015, me qëllim të integrimit të fushave në gjendjen ekzistuese dhe të planifikuar.

4. Pjesa Hartografike që duhet të plotësohet në bazë të Ligjit Nr. 04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor neni 19 dhe Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr. 03/2019 Për Mirëmbajtjen e Bazës së të Dhënave dhe obligimet e autoriteteve publike dhe personave tjerë fizik dhe juridik për mirëmbajtjen dhe dorëzimin e dokumenteve dhe të dhënave në Bazën e të Dhënave dhe U.A. MMPH Nr. 24/2015 neni 23 paragrafi 2.

		Posedimi hartës	përmbajtja	HILUCS	KHRRP	simbologjia	koment
	1.1. harta e destinimeve për zona urbane dhe rurale;	po	Po	jo	jo	Po	
	1.2.harta e shfrytëzimit të planifikuar të tokës nga Plani Zhvillimor Komunal;	po	po	jo	jo	pjesshëm	
	1.3.harta e përdorimi të tokës, duke përdorur HILUCS klasifikimit të dhënave të parashikuara në shtojcën Nr.05 të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 03/2019;	Pjesërisht	jo	jo	jo	Pjesërisht	Nuk është marrë parasysh kërkesa ligjore për plotësim
	1.4.hartat e Instruksioneve të Zonimit, duke përdorur HSRLC klasifikimin e të dhënave siç parashikohet në Shtojcën 6 të Udhëzimit Administrativ(QRK) Nr. 03/2019;	jo					Nuk është marrë parasysh kërkesa ligjore për plotësim
	1.5.hartat administrative, e përbërë nga kufijtë e komunave, zona kadastrale dhe parcelat kadastrale, harta topografike dhe ortofotot, të cilat janë të marra nga Agjencia Kadastrale e Kosovës;	po	pjesshëm	jo	jo	pjesshëm	Nuk është marrë parasysh kërkesa ligjore për plotësim
	1.6.hartat bazike obligative, siç parashikohet në Udhëzimin Administrativ MMPH - Nr.24/2015						

Faqe11nga15

	mbi elementet themelore dhe Kërkesat për projektim, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale Komunale, duke përfshirë:						
	1.6.1. emërtimet gjeografike dhe topografike;	po					
	1.6.2. kufijtë administrativ të komunave;	po					
	1.6.3. emërtimet dhe kufijtë territorial të njësive administrative;	po					
	1.6.4. kufijtë e parcelave kadastrale dhe numrat rendor kadastral;	pjesëri sht					
	1.6.5. sipërfaqet e resurseve ujore sipërfaqësore;	po					
	1.6.6. korridoret e infrastrukturës rrugore;	po					
	1.6.7. vendbanimet dhe të gjitha ndërtimet ekzistuese.	po					
	2. Harta Zonale e Komunës përfshin edhe elementet gjeografike të Hartës Zonale të Kosovës që përcaktojnë shfrytëzimin e tokës dhe udhëzimet zonale në nivel komunal.	Po					
Hartat HZK							
Neni 23. Shtresat e përgjithshme	**Pjesa Hartografike në bazë të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 24/2015**	**Posedimi i hartës**	**përmbajtja**	**HILUCS**	**KHRRP**	**simbologjia**	**koment**
	Harta e shtrirjes së Vendbanimeve ekzistuese dhe zgjerimet e planifikuara nga PZHK	po	po	jo	jo	pjesërisht	
	Harta e shfrytëzimit të planifikuar të tokës nga PZHK;	po	po	jo	jo	pjesërisht	
	Harta me sipërfaqet ekzistuese dhe të planifikuara për aktivitete ekonomike;	po	pjesërisht	jo	jo	pjesërisht	
	Harta me sipërfaqe të pyjeve, resurseve sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe zonat e mbrojtura ujore	po	pjesërisht	jo	jo	pjesërisht	

Faqe12nga15

	Harta e shfrytëzimit të tokës bujqësore:	po	pjesërisht	jo	jo	pjesërisht	
	Harta e pyjeve dhe tokave pyjore	po	pjesërisht	jo	jo	pjesërisht	
	Harta e sipërfaqeve ekzistuese dhe të planifikuara për turizëm	po	pjesërisht	jo	jo	pjesërisht	
	Harta me sipërfaqe për aktivitete komerciale , industrial dhe teknologjike	po	pjesërisht	jo	jo	pjesërisht	
	Harta me sipërfaqet e mbrojtura, Zonat e Veçanta , Zonat e Veçanta të Mbrojtura dhe Zonat Mbrojtëse.	po	pjesërisht	jo	jo	pjesërisht	
1	**Harta e të dhënave bazë** **Neni 24** (shtresë bazë për të gjitha hartat e tjera)	Po	Po	Jo	Jo	Po	
2	**Neni 25** **Harta me sipërfaqet dhe ndërtimet me rëndësi për Kosovën** (shtresë bazë për të gjitha hartat e tjera)	Po	Po	Jo	Jo	Po	Të plotësohet me HILUCS dhe KHRRP
3	**Neni 26** **Harta Zonale e shfrytëzimit të tokës**	Po	Pjesërisht	Pjesërisht	Jo	Po	Të plotësohet sipas HILUCS dhe KHRrP. –plotësim Të punohet harta e detajuar e shfrytëzimit të tokës për zonën urbane edhe për zonat rurale Paraqitja e zonave dhe nën-zonave vlen për të gjitha hartat duke u bazuar në plotësimet që janë kërkuar në pjesën tekstuale, duke i dalluar nën zonat me shkronja dhe numra , sepse harta nuk mund të lexohet.
4	**Neni 26** **Harta Zonale e shfrytëzimit të tokës –në zonën urban**		Pjesërisht	Pjesërisht	Jo	Po	Të plotësohet sipas HILUCS dhe KHRrP.- -plotësim Të plotësohet me elementet si shtresa bazë nga neni 24 dhe 25 i UA. MMPH Nr. 24/2015 dhe U.A. MMPH Nr. 08/2017 NTPH kap. I dhe V. Paraqitja e zonave dhe nën-zonave vlen për të gjitha hartat duke u bazuar në plotësimet që janë kërkuar në pjesën tekstuale, duke i dalluar nën zonat me shkronja dhe numra , sepse harta nuk mund të lexohet Paraqitja e zonave dhe nën-zonave te zonat komerciale dhe zonat industriale
5	**Neni 27** **Harta e shfrytëzimit të tokës të bujqësore**	Po	Pjesshme	Jo	Jo	Pjesshme	-Harta të plotësohet sipas kërkesave U.A. MMPH Nr. 08/2017 NTPH kap. II neni 1 dhe Kap I neni 2 dhe 3 (HILUCS dhe KHRRP).

Faqe13nga15

6	**Neni 28** **Harta e Infrastrukturës Rrugore** (korridoret e inf. Rrugore dhe sipërfaqet transportuese)	Po	Pjesërisht	Jo	Jo	Po	Të plotësohet me elementet nga U.A. MMPH Nr. 08/2017 NTPH kap. I (HILUCS dhe KHRRP) dhe V. Në bazë të 1.3. të nenit 28 të paraqitet nivelimi i rrugës publike. Mungojnë rrugët jo të motorizuara
7	**Neni 29** **Harta e infrastrukturës publike dhe sociale** (sipërfaqet e infr. Publike dhe sociale për zhvillim)	po	Pjesërisht	jo	jo	Po	Të plotësohet me elementet nga U.A. MMPH Nr. 08/2017 NTPH kap. I (HILUCS dhe KHRRP) Të harmonizohet paraqitja grafike e infrastrukturës publike dhe sociale me planin e veprimit dhe në harmoni me PZHK të miratuar. Të plotësohet me kërkesat e U.A. MMPH Nr. 24/2015 neni 29 paragrafi 1 nën paragrafet 1.1. ; 1.2. dhe 1.9. Të bëhet dallimi i përmbajtjes sipas kornizës ligjore në mes Të hartës së planit të Infrastrukturës Publike dhe Sociale të PZHK dhe **Harta e Infrastrukturës Publike dhe Sociale** të **HZK**
8	**Neni 30** **Harta e infrastrukturës Teknike** (shtrirja e rrjeteve dhe kapacitetet e ndërtesave përcjellëse , shiritat mbrojtës dhe pajisjet të përcaktuar për zhvillim)	po	pjesërisht	jo	jo	Po	Të plotësohet me elementet nga U.A. MMPH Nr. 08/2017 NTPH kap. I (HILUCS dhe KHRRP) Të plotësohet me kërkesat e U.A. MMPH Nr. 24/2015 neni 30 paragrafi 1 nën paragrafet 1.3.; 1.9.,; 1.9. dhe 1.10.
9	**Neni 31** **Harta e Zonave Mbishtresore**	po	Pjesërisht	jo	jo	Pjesërisht	Harta të punohet sipas kërkesave ligjore të nenit31 pika 1 dhe 2 të U.A. MMPH Nr. 24/2015 dhe simboleve të dhëna në sipas UA MMPH Nr. 08/2017 Kap V. Të plotësohet me elementet nga U.A. MMPH Nr. 08/2017 NTPH kap. I (HILUCS dhe KHRRP) Mungon zona e Vërshimit në zonën Urbane të Gllogocit Zona e aeroportit bujqësor të paraqitet si zonë mbishtresore.
10	**Neni 32** **Harta e Vendbanimeve Joformale**	po	Pjesërisht	jo	jo	jo	Harta të punohet sipas kërkesave ligjore të nenit32 të U.A. MMPH Nr. 24/2015 dhe simboleve të dhëna në sipas UA MMPH Nr. 08/2017 Kap I, III, V.
11	**Neni 33** **Harta e Planeve Rregulluese**	po	Po	jo	jo	Po	Të plotësohet me elementet nga U.A. MMPH Nr. 08/2017 NTPH kap. I (HILUCS dhe KHRRP)
12	**Harta e e Zonës ekonomike** (Harta me sipërfaqet ekzistuese dhe të planifikuara për aktivitete ekonomike;)	po	Pjesërisht	Jo	jo	Pjesërisht	Të paraqiten sipërfaqet ekzistuese dhe ato të planifikuara, të bëhet dallimi.

13	**Harta e Zonës komerciale dhe industriale** Harta me sipërfaqe për aktivitete komerciale , industrial dhe teknologjike)	po	Pjesërisht	jo	jo	Pjesërisht	Të bëhet dallimi i përmbajtjes sipas kornizës ligjore në mes Të hartës së planit të Zhvillimit ekonomik të PZHK dhe **Harta e Zonës Komerciale dhe Industriale të HZK**
14	**Harta e Zonës pyjore** (Harta e pyjeve dhe tokave pyjore)	po	Pjesërisht	jo	jo	Pjesërisht	Të paraqiten nën-zonat në kuadër të zonave të përcaktuara duke u bazuar në shfrytëzimin e tokës sipas HILUCS dhe KRRPH duke përfshirë edhe Kushteve zhvillimore.
15	**Harta e Zonës rekreative-turistike**	po	Pjesërisht	jo	jo	Pjesërisht	Në hartat tematike të paraqiten edhe ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuar sipas kërkesave të neni 29 të UA. Nr. 24/2015 duke përdor simbolet nga NTPH kapitulli V. Të paraqiten zonat dhe kushtet zhvillimore sipas Projekt-HZK për sipërfqet në zonë duke pas për bazë nenin 23
16	**Harta e Zonës së banimit**	po	Pjesërisht	jo	jo	Pjesërisht	Harta të hartohet në bazë të kërkesave ligjore tënenit 26! Në hartat tematike të paraqiten edhe ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuar sipas kërkesave të neni 26 të UA. Nr. 24/2015 duke përdor simbolet nga NTPH kapitulli V. **Të merret parasysh U.A.** (QRK) Nr. 03/2019; SHTOJCA 5 dhe Shtojca 6.
17	**Harta e Zonës së rezervave minerare dhe fushave të eksplatimit**	po	Pjesërisht	jo	jo	Pjesërisht	Harta të punohet sipas kërkesave ligjore të U.A. MMPH Nr.24/2015 Të bëhet dallimi në paraqitje hartografike të rezervave minerare , fushave të eksploatimit dhe resurseve nëntokësore. Të paraqiten elementet e paraparapara si masa mbrojtëse
18	**Harta e Zonave të Mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe natyrore**	po	Pjesërisht	jo	jo	Pjesërisht	
19	**Shtresat e përgjithshme**	po	po	-	-	po	
20	**Harta e pellgjeve sipërfaqësore të burimeve të ujit**	po	po	jo	jo	po	
21	**Harta e sipërfaqeve ujore**	po	po	jo	jo	po	
22	**Harta e zonave të mbrojtura sanitare dhe burimeve nëntokësore të ujërave të pijshëm**	po	po	jo	jo	po	
23	**Harta e zonave mbrojtëse të lumenjve kryesor**	po	po	jo	jo	po	
24	**Harta e zonave të përcaktuara për bonus të zonimit**	po	pjesërisht	jo	jo	jo	

Faqe15nga15

Vendimi për shqyrtimin publik të projekt – Hartës Zonale të komunës së Gllogocit për periudhën 2021-2029

Republika e Kosovës
Komuna Drenas (Gllogoc)
Kuvendi i Komunës

12 Nr 6001- 2375 0 dt. 29.06. 2021

Bazuar në nenit 10 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 dhe 2.2, nenit 11, nenit 16 paragrafi 1, 2, 3 dhe nenit 20, të Ligjit Nr.04/L-174, për Planifikimin Hapësinor, nenit 4 paragrafi 3 nënparagrafi 3.2, nenit 7 paragrafi 2 dhe 3, nenit 8, 10, 12 dhe 14, të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.05/2014, për pjesëmarrjen e publikut në Planifikimin Hapësinor, Njoftimit për marrjen e Vendimit për hapjen e shqyrtimit publik të Projekt ''Harta Zonale e Komunës 2021-2029 Gllogoc Nr.2442-2/21, datë 28.06.2021, nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në bazë të nenit 11,12 dhe 40, të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34.pika 34.6, të Statutit të Komunës së Gllogocit, Kuvendi i Komunës së Gllogocit në mbledhjen e mbajtur të dt. **29.06.2021**, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR SHQYRTIMIN PUBLIK TË PROJEKT- HARTËS ZONALE TË KOMUNËS SË GLLOGOCIT PËR PERIUDHËN 2021-2029

Neni 1
Kuvendi i Komunës së Gllogocit të miratoj vendimin për shpalljen në shqyrtimin publik të Projekt-Hartës Zonale të Komunës së Gllogocit për periudhën 2021-2029.

Neni 2
2.1 Hapja zyrtare e shqyrtimit publik dhe prezantimi i Projekt- Hartës Zonale të Komunës së Gllogocit 2021-2029, bëhet në sallen e Kuvendit Komunal.
2.2 Shqyrtimi publik i Projekt-Hartës Zonale të Komunës së Gllogocit 2021-2029, zgjat 30 ditë, sipas procedurave të përcaktuara me ligj.
2.3 Shpallja e shqyrtimit publik të Projekt- Hartës Zonale të Komunës së Gllogocit 2021-2029, bëhet tetë ditë para hapjes së tij përmes mjeteve të informimit publik, përkatësisht ueb faqës së Komunës.

Neni 3
3.1 Në shqyrtimin publik prezantohet pjesa tekstuale dhe grafike e Projekt- Hartës Zonale të Komunës së Gllogocit 2021-2029.

3.2 Në shqyrtimin publik prezantohen fazat e Projekt- Hartës Zonale të Komunës së Gllogocit 2021-2029: Kushtet e përgjithshme zhvillimore, lista e zonave, zonat e përcaktuara dhe kushtet zhvillimore të tyre, kushtet zhvillimore për shfrytëzimet e veçanta, zonat mbishtresore dhe kushtet zhvillimore të tyre, infrastruktura rrugore, infrastruktura publike dhe sociale, infrastruktura teknike, trajtimi i vendbanimeve joformale, plani i veprimit për zbatim të Hartës Zonale të Komunës.

3.3 Projekt- Harta Zonale e Komunës së Gllogocit 2021-2029, është i qasshëm, për publikun në formë të shtypur dhe elektronike.

1

Neni 4

4.1 Projekt- Harta Zonale e Komunës së Gllogocit 2021-2029, u nënshtrohet vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve të publikut para se të finalizohet.

4.2 Të gjitha vërejtjet, komentet dhe sugjerimet që paraqiten nga publiku gjatë diskutimeve, me shkrim, në librin e vërejtjeve apo përmes adresës elektronike, brenda afatit kohor të përcaktuar, përfshihen në raportin mbi shqyrtimin publik.

Neni 5

Shqyrtimi publik i Projekt- Hartës Zonale të Komunës së Gllogocit 2021-2029, organizohet nga Komuna në kuadër të kompetencave ligjore.

Neni 6

6.1 Me këtë vendim parashihen sigurimi i kushteve teknike dhe financiare që nevojiten gjatë kohës së shqyrtimit publik të Projekt-Hartës Zonale të Komunës së Gllogocit 2021-2029.

6.2 Pjesë përbërëse e këtij propozim vendimi do të jetë edhe plani i organizimit të aktiviteteve gjatë kohës së shqyrtimit publik (prezantimi i HZK-së, njoftimi i qytetarëve, sigurimi i materialit elektronik dhe fizik i HZK-së dhe veprimet tjera për të siguruar një qasje normale të qytetarëve në Hartën Zonale të Komunës).

Neni 7

Për zbatimin e këtijj vendimi do të kujdeset:Kryetari I Komunës dhe Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 8

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPL si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Kryesues i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit

2

Fotografit e hapjes se shqyrtimit publik

Hapja e Shqyrtmit Publik të Hzk-së

Fotografi nga hapja e shqyrtimit publik të Hzk-së

Procesverbali i hapjes së Shqyrtimit Publik

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada – Government

Komuna e Gllogocit

Opština Gllogovac-Municipality of Gllogoc

I hartuar me dt: 12.07.2021 Ora :10:00

PROCESVERBAL:

I Shqyrtimit Publik të **"Projekt dokumentit- Harta Zonale e Komunës së Gllogocit 2021-2029".**

Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, Komuna e Drenasit harton procesverbal rreth Shqyrtimit publik "Projekt dokumenti - Harta Zonale e Komunës së Gllogocit 2021-2029", i hapur sot me datë 12 korrik 2021, në ora 10:00 në sallen e Kuvendit të Komunës.

Të pranishëm janë:

1. Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci

2. Nënkryetari i Komunës së Drenasit, Arben Shala

3. Drejtoresha për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit , Flutura Avdiu

4. Drejtoresha e Kompanisë hartuese Plan-A Consulting, Sadije Deliu

5. Drejtor të Drejtorive Komunale

7. Zyrtar Komunal

8. Përfaqësues të GIZ-Gjerman

9. Qytetarë të Komunës së Drenasit

Lënda:

Hapja zyrtare e Shqyrtimit publik të "Projekt dokumentit - Harta Zonale e Komunës së Gllogocit 2021-2029"

Mbarvajtja:

Drejtoresha për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit , Flutura Avdiu, bëri hapjen zyrtare të shqyrtimit publik të "Projekt dokumentit - Harta Zonale e Komunës së Gllogocit 2021-2029".

Flutura Avdiu- I nderuari Kyretar, të nderuar përfaqësues të sektorit publik, të sektorit privat, kompanisë hartuese, drejtor të drejtorive komunale, ju faleminderit që keni gjet kohë për pjesëmarrje në këtë shqyrtim publik të Hartës Zonale të Komunës së Drenasit për periudhën 2021-2028.

Hapja e shqyrtimit publik bëhet sot me qellim që të bëhet pjesëmarrje interaktive nga ana juaj para se ky dokument të finalizohet dhe të marrë miratimin perfundimtar nga ana e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Sot përmes prezantimit që do të bëhet para jush të Projekt dokumentit, ju do të keni mundësi të shihni inkorporimet që janë bërë në këtë dokument gjatë hartimit të tij dhe të të jepni komentet sygjerimet, vërejtjet tuaja me shkrim, në afat prej 30 ditësh të cilat mund t'i paraqitni në Librin e Vërejtjeve të cilin do ta gjeni në katin e parë tek sporteli, gjithashtu në email-in zyrtar të komunës, dhe në përputhje me Ligjin për Planifikim Hapësinor do t'i inkorporojmë këto, duke pasur parasysh edhe qellimet e juaja. Andaj ne sot e shpallim të hapur Shqyrtimin Publik të "Projekt dokumentit - Harta Zonale e Komunës së Gllogocit", fjalën ia kaloj Kryetarit të Komunës, i cili do ta shtjellojë procesin e këtij hartimi shumë të rëndesishëm të Projektit të Planifikimit Hapësinor i cili është në fuqi për një periudhë 8 vjeçare.

Kryetari Ramiz Lladrovci – Të nderuar qytetar, përfaqësues të sektorit publik, sektorit privat, përfaqësues të GIZ-it Gjerman, përfaqësues të Kompanisë hartuaese të përzgjedhur nga GIZ, kam kënaqësinë që sot të bëjë Hapjen Zyrtare të Shqyrtimit Publik të "Projekt dokumentit - Harta Zonale e Komunës së Drenasit për vitin 2021-2029".

Hapja e Shqyrtimit Publik të Hartës Zonale të Komunës bëhet me qëllim që të zhvillohen konsultime dhe që të inkurajohet pjesëmarrja transparente e publikut në hartimin e këtij dokumenti të planifikimit hapësinor që përmes grafikoneve, hartave dhe tekstit përcakton hollësisht llojin, destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimit të cilat bazohen në kohëzgjatje dhe projeksione të arritshme të investimeve publike dhe private për tërë territorin e komunës tonë, për një periudhë së paku (8 vjeçare).

Si Kryetar i Komunës jam shumë i lumtur që gjatë qeverisjes tonë kemi arritur të finalizojmë dhe të miratojmë dy dokumentet me të rëndësishme të planifikimit hapësinor siç janë Planifikimi Zhvillimor i Komunës së Gllogocit 2020-2028 dhe Harta Zonale e Komunës së Gllogocit 2021-2029, ashtu siç përcaktohet në Ligjin Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor.

Falenderim i veqantë për kontribuesit e hartimit të Hartës Zonale të Komunës, Ekipin Komunal të Planifikimit, kompaninë e GIZ-it gjerman për rekomandimet dhe mbështetjen teknike, kompaninë hartuese Plan-A Consulting, Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, për dhënien e kontributit të jashtëzakonshëm gjatë gjithë këtij procesi.

Gjatë periudhës së shqyrtimit publik qytetarët e Komunës së Drenasit do të kenë mundësi që të japin vërejtjet, komentet dhe sugjerimet, të cilat pastaj në harmoni me ligjin do të inkorporohen në dokumentin e Hartës Zonale të Komunës për periudhën kohore 2021-2029.

Shqyrtimi publik do të zgjatë 30 ditë që nga dita e sotme e hapjes. Vërejtjet, komentet dhe sugjerimet mund të bëhen në librin e vërejtjeve apo përmes e-mailit zyrtar komuna.drenas@rks-gov.net.

Faleminderit për pjesëmarrje.

Flutura Avdiu- Faleminderit kryetar, e ftoj arkitektin Agron Kuliqin, që të bëjë prezanitimin e projekt dokumentit.

Agron Kuliqi- Përshëndetje për të gjithë, si hyrje për këtë paragraf të prezantimit shtrohet pyetja se qka paraqet Harta Zonale Komunale, është një dokument multisektorial me karakter rregullues, përmes së cilës definohet në hollësi ndarja e territorit të Komunës Drenasit, në zona të tilla si hapësira të lira, hapësira të banimit, industria, bujqësia, aktivitetet ekonomike, etj.

Cili është qellimi i këtyre Hartave Zonale, është që përmes përmbushjes së kërkesës ligjore t'i ofrojë qeverisjes komunale një instrument të mirë për planifikim të qëndrueshëm hapësinor dhe për kontroll të zhvillimit.

Harta Zonale Komunale është dokument multisektorial me karakter rregullues përmes së cilës definohet në hollësi ndarja e territorit të Komunës së Drenasit, në rastin tonë në zona të tilla si hapësira të lira, hapësira të banimit, industria, bujqësia, aktivitetet ekonomike, etj.

Cilat janë kërkesat dhe obligimet që dalin nga Harta Zonale, baza themelore për hartimin e Hartës Zonale, sipas draftit të hartuar është vizioni që të gjitha rrugët kalojnë nëpër Drenas. Kjo është një mënyrë që deri me tani nuk kemi mundur ta shfrytëzojmë si duhet, për shkak të rrethanave të krijuara deri me tani.

Drenasi si zonë në qendër të Kosovës duhet të ketë një ekonomi të bazuar në zhvillim të qendrueshëm rural, me përkrahje të bizneseve, industrisë dhe infrastrukturës funksionale.

Obligimet që dalin nga Harta Zonale Komunale janë shfrytëzimi i planifikuar i tokës dhe zgjidhja e qështjes së banimit.

Deri në vitin 2029 parashihet që të përmbushet kërkesa ndërtimore për banim, bujqësi dhe industri, diku me rreth 186 hektar tokë ndërtimore, ku parashihet që qyteti i Drenasit të dendësohet, të plotësohen hapësirat e pazhvilluara deri me tani dhe të përcaktohet kufiri i ri ndërtimor.

Komuna e Drenasit edhe më heret ka pasur një Plan Rregullativ Urban dhe Harta Zonale, që kanë qenë të bazuara në legjislacionin e kaluar, ndërsa Palni i ri është mbështetur në legjislacionin aktual, i cili do të zëvendësojë planin e kaluar urban.

Rregullimi i zonave të banimit në tërë territorin e komunës, përfshihen dimensionet e parcelës, lartësia e ndërtesës, vendosja e objektit në parcelë, distancat ndërmjet objekteve, treguesit e vijave në kuptimin e vijave ndërtimore, rregullative, formësimi arkitektonik dhe estetik, kërkesat për efiçiencë të energjisë, masat për mbrojtje nga zjarri, etj.

Shfrytëzimet e tokës në çdo zonë përcaktojnë shfrytëzimet e lejuara dhe të veçanta, ku hyjnë zona pyjore, bujqësore me konsum privat dhe tragtar, zona turistike dhe retoraktive, zona komerciale dhe industriale, sipërfaqet ujore, zonat minerare dhe fushat e eksploatimit.

Zonat pyjore përfshijnë siperfaqet e mbuluara me pemë, duke përfshirë bashkësitë bioekologjike, ku përfshihen shfrytëzimet e lejuara, shfrytëzimet dytësore, shfrytëzimet e përkohshme dhe shfrytëzimet e ndaluara. Të gjitha janë të definuara në Planin Hartën Komunale Zonale.

Pastaj vjenë zona bujqësore në konsum privat dhe tragtar, përfshinë tokën e shfrytëzuar për kultivim të kulturave bujqësore.

Zona turistike dhe rekreative, zona komerciale dhe industriale, siperfaqet ujore përfshijnë pasuritë ujore si Lmenjtë “Drenica” dhe “Verboci”, Liqeni i “Vasilevës”, burimet e ujit mineral në Poklek, dhe burimet tjera nëntokësore të ujit të pijshëm dhe burime tjera siperfaqësore.

Zonat e rezervave minerare dhe fushat e eksploatimit, të gjitha këto zona janë detajishtë të definuara në Draftin e Hartës Zonale Komunale.

Harta Zonale e Banimit, si zona e banimit shumë të ulët të parapara 0-15 njësi të banimit, ose deri në 70 banorë për hektar, apo 231 hektar në total. Zonat e banimit Rurale do të synohet ruajtja e karakterit rural, ndërtimi me ishuj do të parandalohet, dëndësia e banimit në këto banime është 0-15 njësi të banimit për hektar, të planifikuara zona rurale të përgjithshme, me intenzitet të ulët dhe siperfaqe rurale me intenzitet të lartë. Zona e banimit ne dendësi të ulët të parapara me 15-25 njësi të banimit. Zona e banimit me dendësi të mesme, përfshinë 26-40 njësi të banimit për hektar, etazhiteti në këtë kategori arrin në P+3 dhe P+5. Zona e banimit me dëndësi të lartë do të përfshijë një kategori me mbi 40 njësi banimi për hektar, apo deri në 182 banor për hektar, dhe përfshinë siperfaqen qendrore të pjesës urbane të qytetit, etazhiteti P+7, mirëpo ka kaluar deri në P+12.

Kushtet zhvillimore për shfrytëzime të veqanta vlejnë për të gjitha zonat e listuara më lartë, mirëpo duhet të përmbushin kushtet shtesë të paraqitura në Draftin e Hartes Zonale Komunale.

Zonat mbishtresore dhe kushtet zhvillimore të tyre, vendosen mbi një apo më shumë zona, dhe kanë përparësi ndaj zonave bazë, për resurse kulturore, historike, ekonomike, turistike të cilat nuk janë adresuar në zonën bazë.

Infrastruktura rrugore, bazuar në Udhëzimin Administrativ per normat teknike të Planifikimit Hapësinor, rrjeti i Infrastrukturës Rrugore ndahet në rrjet kombëtar dhe rrjet lokal të infrastrukturës rrugore.

Infrastruktura publike, Infrastruktura teknike janë të përcakutara detaishtë në Hartën Zonale Komunale.

Vendbanimet joformale të banimit në Komunën e Drenasit janë tre: në Lagjen e Feronikelit, Lagjen Roga dhe në Lagjen e re në Komoran, në këto vendbanime janë të parregulluara qështjet pronësore juridike, mirëpo në Hartën Zonale janë paraparë disa kritere që do të na mund%sojnë në përmirësimin e këtyre zonave.

Sa i përket Hartave Zonale dhe draftit të hartuar në qershor të këtij viti kaq kisha, ju faleminderit .

Flutura Avdiu- Ju faleminderit për prezantimin e projekt dokumentit nga ana e arkitektit, andaj ju ftojmë për debat publik.

Kyretari Lladrovci- jep sqarime të detajuara rreth zhvillimit të procedurave të Hartimit të Hartës Zonale të Komunës, sfidat dhe vështirësitë.

Sadije Deliu- Drejtoresha e Kompanisë Plan-A Konsulting e cila ka mbështetur Hartimin e Draft Hartës Zonale Komunale, siq e ceku kryetari Harta Zonale po hartohet për here parë dhe Komuna e Drenasit është ndër të parat që e ka hartu, mirëpo kjo hartë e ka për obligim ligjor të bazohet totalishtë në Planin Zhvillimor Komunal i cili ka hyrë në fuqi para një viti.

Flutura Avdiu- të nderuar qytetarë, perfaqësues të sektorit privat dhe publik, debatin e shpallim të hapur për këtë dokument të planifikimit hapësinor, kështu që para se të merrni fjalën ju lutëm të prazantoheni dhe të parashtroni kërkesat e juaja, andaj ksh dëshiron të marr fjalën ju lutëm urdhëroni.

Zekë Kluna- qytetarë- unë i kam tri kërkesa: e para ne kemi problem me Hartë Zonale në Poklek të Vjetër ajo prone është pronë ndërtimi, kurse neve nuk na lejohet me u ndertu? , e dyta rreth asfaltit që është ndërtu aty është zone malore, a kemi të drejtë me ndërtu villa aty?, e treta për miniera minerale na e kemi një ujë brimor në Poklek e nuk e shfrytëzojmë a kemi të drejtë me ndërtu fabrikë? Pse në Poklek nuk na është leju me ndërtu, është denu njeri me gjobë 5 mijë Euro.

Kryetari Lladrovci- Ne e kemi Planin Zhvillimor Komunal, gjithashtu Hartën Zonale në draft dhe qkado që mund të inkorporojmë do të inkorporojmë bazuar në legjislacionin në fuqi, pra aty ku e keni tokë bujqësore nuk mundet me u ndërtu dhe keni marrë gjoba për shkak se keni fillu me ndërtu pa zhvilluar procedurat ligjore për leje ndërtimore.

Armend Gashi-qytetar- E kam pa draftin në web faqe të komunës, dhe tek zona e ndertimit qe e keni vendosnjë kusht që me pas minimum 25 ari për mu leju me ndërtu, unë mendoj që është një klusht shumë i madh për arsye se kerkush në Drenas nuk i ka vet personalisht 20 ari, por nesre bën ndonjë marrveshje me komshinjë mundet me pas problem, deshta me pyet a ka ndojnë procedurë që të paktën mu leju me qenë më e ulët.

Kryetari Lladrovci- nuk e kemi kusht ne është ligji, janë rregulloret që nuk na lejojnë me vepru ndryshe.

Sadije Deliu- Drejtoresha e Kompanisë hartuese Plan-A Consulting, janë norma teknike të planifikimit hapësinor të cilat e obligojnë varësishtë prej koficientit sa duhet me qenë edhe parcela minimum e vogël, ata e kanë përcaktu ne vetëm I kemi marr prej udhëzimit administrative këto norma dhe i kemi vendos.

Abdullah Morina- qytetar nga fshati Çikatovë e Vjetër, në bazë të draftit parashihet se te zona qendër bodrumi të jetë 60% sipas projektit, mendoj se hapësirat e parkingjeve janë më se të nevojshme për invesitorin ose për banorët, me 60 % nuk ka mundësi të plotësohet kërkesa e banorëve.

Kryetari Lladrovci- në qoftëse është gabim teknik nga koficienti 4.2 do ta përmirësojmë, në qoftëse nuk është gabim teknik atëherë do të mbetet ashtu siq është paraparë në draft, ashtu siq e rregullon ligji.

Remzi Krasniqi- qytetar i Drenasit- Mendimi im rreth Hartës Zonale, i kam dy pika që më interesojnë, do të thotë tranzitet dhe hyerjet në qytetin e Drenasit, prej "Kroit të Mbretit" si kanë me funksionu. Gjithashtu u përmenden Pishina Gjysmëolimpike në Komoran, propozimi im si qytetar i thjeshtë kishte me qenë që të bëhet një ndërhyerje që të ketë qasje edhe Drenasi edhe qytetarët tek ajo pikë rekreative.

Kryetari Lladrovci- të interesojnë tranzitet ose hyerjet në qytet, duke filluar nga "Kroi i Mbretit", 2012 është nis një rrugë në drejtim të Feronikelit, që unë mendoj se ajo rrugë paguar një herë, jemi duke i ndjekur këto procedura, e kemi shpall interes të përgjithshëm, është bërë vlerësimi nga Ministria e Financave dhe jemi duke i paguar ato prona. Brenda në qytet gjithashtu jemi duke punuar në lehtësim të jetës së qytetarëve, pra përveq rrugës që është duke u punuar mbrapa Stacionit të Autobusëve, po provojmë t'i ikim rrethit rrotullues, gjithashtu do ta bëjmë hapjen e sheshit prej objektit të "Al Trades" deri tek rrethi në QKMF, rrugë nëntokësore me dalje në rrugë tjera, parkingje nëntokësore për aq sa na lejohet në të dy anët e rrugës, të gjitha i keni të detajuara në hartën Zonale të cilën po ua prezantojmë dhe gjithashtu e keni pasur mundësinë me shiku në web faqe të komunës.

Flutura Avdiu- Drejtoreshë- dikush tjetër a dëshiron të marr fjalën.

Meriton Neziri- qytetar-ndertues tek rruga "Bejtë Rexhepi", më janë nderprerë punimet për shkak të lejes dhe lejen nuk e kemi për shkak se është pronë në komasacion, deshta me pyet qka është e mundshme me ba rreth kësaj prone, a na lejohet ndërtimi apo jo?

Kryetari Lladrovci- ndërtimet ku janë realizuar kundërligjshëm, në pronat nën komasacion nuk mund të ndërtohet.

Sadije Deliu- Ligji i bujqësisë mund ta shihni edhe vet në internet, nën ujitje nuk lejohet asnjë ndertim në interes privat vetëm në interes të përgjithshëm, që mundet të konsiderohet rruga.

Flutura Avdiu- Atëhere nëse nuk dëshiron dikush tjetër të marrë fjalën, e shpallim të mbyllur këtë debat publik, gjithashtu ju noftojmë edhe njëherë që e keni afatin prej 30 ditësh të paraqitni komentet, sygjerimet e juaja me shkrim, në Librin e Vërejtjeve, në email-in zyrtar të komunës apo në kërkesat e protokoluara në zyrët e Drejtorisë së Urbanizmit.

Ky procesverbal përmbyllet me datë 12.07.2021, në ora 11:30.

Procesmbajtës:

_____

Albulena Lushtaku-Hetemi

Kryesuesi i Komisionit:

_____

Flutura Avdiu

Tabela me të gjitha komentet të cilat kanë arritur gjatë fazës së shqyrtimit publik dhe arsyetimi me shkrim për secilin koment

Nr.	Lokacioni i parcelës	Parashtruesi /data	Komenti/ vërejtja	Aprovohet /refuzohet	Arsyetimet për miratim apo refuzim të porpozimeve dhe vërejtjeve të qytetarëve.
1.		**Hazir Kluna** **16.07.2020**	(1) KËRKES – UNË UNE HAZIR HALIM KLUNA PRONAR I PARCELES 495-0 NE POKLEK KERKOJ QE TË PERFSHIHET NË RAJON NDERTIMI EDHE PARCELA 495-0 NE POKLER. PER ARSYE SE KJO PARCEL PRA PARCELA 495-0 ME VENDIMIN E PLANIT DETAL URBAN NR 01-06-2 TE VITIT 27 MAJ 1977 I SHPALLUR NE GAZET ZYRTARE NR 22,633 ME DAT 22 GUSHT 1977. PARCELA 495/0 ËSHTË NË RAJON NDERTIMOR PRANDAJ JU LUTËM QË TË FUTNI E NË HART ZONALE SI RAJON NDERTIMOR UNE SI QYTETAR I KËSAJ KOMUNE JAME DËMTUAR SERSE NË JANË NDAZUR PUNIMET, UNË KAM MAPAUK NGA PERGJIGJI ME INVESTUAR NË KOSOVË NË PRONËN TIME E CILA ËSHTË NË RAJON NDERTIMOR. JU LUTËM TË KEM KONSIDERAT DHE TË MERRNI PARASYSH KËRKESËN TIME TË LIGJSHME. ME RESPECT: HAZIR HALIM KLUNA DRENAS 16.07.2021	Refuzohet	Kufiri ndërtimor është caktuar me Planin Zhvillimor Komunal 2020-2028.

2.		**Zekë Kluna** **19.07.2021**	Kalkoçi (2) unë si Administrator i fshatit Pokleki te njëtën kërkoj qe te perfshihet kjo zonë ne hartën Ndërtimore sa ne rrugën Kaqanikë e qëndër deri te Lagja e feronikëve te jet zonë Ndërtim e ja tona ndalohet Ndërtimet unë si Administrator i vshtërit Pokleki kemi kohë peticjonë Drejtorisë urbanizmit nese kohë mundësi te shqyrtohet edhe njëherë kjo çështje se jemi te interesuar shumë banorë te Pokleku te Ndërtojnë por vetëm rugës ndërsa juka ndërpre pana Hazir H. Klunës qe te mësë ndërtonë por gjaqi arsyje kjo zonë dhe kjo parcelë janë Zona te Ndërtimit ju lutëm qe te rishikojnë edhe njëherë het Hartë se jemi duke pritë prej Komisionit te vlerësoj bet çështje me Respekt na Administrori i Pokleku Zekë H. Kluna N.P. 1010463129 Tel. 044-296-399 19.07.2021	Refuzohet	Kufiri ndërtimor është caktuar me Planin Zhvillimor Komunal 2020-2028.

3.		**Avni Bujupi** **22.07.2021**	KERKESË: K.K DRENAS (3) UNË AVNI HAKI BUJUPI NGA FSHATI ARLAT K.K. DRENAS BËJ KËRKESË PRANË K.K DRENAS QË PRONA IME ME NR PARCELËS: 00874-4 PËRS 40839 TË ME PËRFSHIHET NË HARTËN ZONALE SI TOK NDËRTIMORE PËR ARSYE SE ËSHË TOK E FLASIT TË PËRT DRENUK OSHË POK PJELLORE NË EKEMI BLEJ PËR TË PËRDOR PËR NAJTEN E BIZNESIT DHE PËR QËLLIME TË HAPJES SË VENDEVE TË PUNËS PËR RRETHIN DHE FAMILJEN PATË QË PLOTËSON TË GJITHA KRITERËT PËR PËR TË INVESTUAR DHE HAPUR VENDE PUNE. KEMI PASUR EDHE KËRKESA NGA INVESTITOR TË JASHTËM PËR INVESTIME POR QË NUK KEMI PASUR MUNDËSI SEPSE NA ESHË NDËRPRE NGA KOMUNA: JUBëJ APEL DHE JU LUS PËRËM-ËRSHËM TË SHQYRTONI KËT KËRKESË SEPSE ËSHË NEVOJË TË FAMILJES. RRETHIT. KOMUNËS DHE GJITHË SHQIPËRISË SË KOSOVËS, SEPSE KEMI PLANE STRATEGJIKË TË INVESTIMIT DHE PUNËSIMIT SI DHE PARCELËS: 00188-1 dhe 00224-2 Me Arlat. ME RESPEKT AVNI BUJUPI NR.LËR: 1408260 51 tel. 044503434 DATË: 22.07.2021	Refuzohet	Kufiri ndërtimor është caktuar me Planin Zhvillimor Komunal 2020-2028.

4.		**Mërgim Olluri**	KOMUNA E DRENASIT (4) DREJTORIA E URBANIZMIT KËRKESË – LUTJE I LUTEM TITULLIT TË LARTËPERMENDUR QË TË SHQYRTOJ DHE TË MË NDIHMOJ LIDHUR ME PERCAKTIMIN E PARCELËS TIME SI TOKË NDERTIMORE E CILA PËRMBUSHTIN ME PZHK ESHTË PARAPARË ZONË PYJORE, PARCELA IME ËSHTË P-00257-6 ZONA KATASTRALE KORROTICË E EPËRME, DHE FAKTIKISHT ESHTË TOKË-MAL I KAT. III DHE SIPAS UDHËZIMIT TË KOMUNËS TUAJ DUKË REFERUAR PËRGJEGJËSISË PER NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË TOKËS I JEMI DREJTUAR MBPZHR-SË E CILA NA KA LEJUAR NDËRRIMIN E DESTINIMIT, KË-662/19 DT: 20.09.2019. DUKË U BAZUAR NË KËTO JU LUS QË TA PËRFSHINI SI ZONË NDËRTIMORE PARCELËN TIME.-PASI QË NUK DEMTOHET TOKA PJELLORE. UNË JAM MËRGIM OLLURI QË MENAGJOJ NË NJË BIZNES QË 15 VITE NË KOMOKAN, JAM I RRE GULLT NË TAKSA DHE NË SHËRBIMË, GJITHASHU JEMI TË PUNËSUAR 5 VETË, DHE SI BIZNES KEMI NEVOJË QË TË ZGJEROHEMI DHE RRISIM KAPACITETIN. PASI QË NUK KAM QENË INFORMUAR PËR RZHK-NË DHE JAM NË VONESË-KËRKOJ QË TË KIHET PARASYSH NË HARTË ZONALE-SI MIKROZONË DHË KONTINUITET ME NDËRTIMET EKZISTUESE MEGJEGJM ME SHPRESË DHE JU LUS QË TË MË NDIHMONI-PASI QË FITIMET E MIJA I KAM SHTI NË KËTË TOKË-PARCELË. FALEMNDERIT. MËRGIM OLLURI 048-741 752.	Refuzohet	Kufiri ndërtimor është caktuar me Planin Zhvillimor Komunal 2020-2028.

5.		**Naim Bazaj** **22.07.2021**	Për : komuna e Gllogocit, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje te Mjedisit - Komisionit për Harten Zonale Komunale 2021 REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY Pranuar 22.07.2021 Nj. Org. 08 Numër 070 Shtojca 33825 Vlerë Nga : Naim Bazaj, Fshati Terstenik Komuna e Drenasit Lenda **Pjesëmarrje ne diskutim publik për hartën Zonale Komunale** - sipas vendimit komunal për DISKUTIM PUBLIK PER HARTEN ZONALE me ketë shkresë marr pjesë ne këtë diskutim dhe kërkoj nga Titulli Lartë cekur qe te propozimet e mia te përfshihen ne hartën zonale duke u krijuar te drejtën time ne te cilinë garanton ligji per planifikim Hapësinorë i Republikës se Kosovës qe parimet themelorë dhe demokratike janë mosdiskriminim i pjesëmarrësve ne palnifikim hapësinorë dhe trajtim i barabartë për te gjithë akteret te cilën përfshihen ne këto procedura te hartimit te planeve 1. Parcela Kadastare nr 00722-0 zona kadastrale Terstenik është sipas planit zhvillimore komunal , me destnim bujqësor; 2. Sipas gjendjes faktike kjo parcel qe nga viti 1970 është një djerrin, dhe gërmime e mbetur nga eksplatimi materjalit mbushës per rrugën Gllogoc-Skenderaj nga ish Kompania "VIADUK i Zagrebit " 3. Me rastin e hartimit te planit zhvillimore komunal nuk është marr ne konsiderat gjendja faktike ANDAJ I propozoj organit kompetent qe vërejtjet e parqitura nga qytetaret te ndikojnë edhe ne korrigjimin këtyre destinimeve, posaçërisht për parcelën me nr 00722-0 dhe ti ipet destinimi për toke ndërtimore, si dhe te konstatohet gjandja faktike ne teren nga ky organ i lartëcekur komunal Ju faleminderit per mirëkuptim Me respekt Naim Bazaj nr personal 1004171400 dhe telef 044/790 006	Refuzohet	Kufiri ndërtimor është caktuar me Planin Zhvillimor Komunal 2020-2028.

6.		**Shaban Neziri** **23.07.2021**	Komuna e Dragashit (5) -Drejtoria e Urbanizmit- Kërkesë Lidhur me titullit të lartëshenuar qe te ka paraqyer se me Zonen e ndërtimit te lirë me Dekretin -III- te paraqitjes ndërtimi i lart repse me planin e parapar është paraqa ndërtim i ulët. Te prronët e parcelave qe janë nga una ne rrugën qe shkon për Krojkovë e deri te Muslit janë te interesuar qe te kënë ndërtim te lart me mes rruges qe shkon për Krojkovë dhe kufirit gjeografik nga parcela Nr. 01-00688 e deri me parcelat 00688-7, 688-4, 688/3 dhe 688-7 qe te jenë nga te kjart kompleks gë nga zona e kufirit e deri te rrugës Shkol e Dhanë qe shkon per Krojkovë. Te keni paraqyer qe si pesë e madhe me at bagë me antu e kundërt janë zonë me kamasacion qe është i nga nënfuar ndërtimi. Andaj duke pas paraqyer nevojen e qytet arve per vendosjen si dhe shumësit qe lejojë ndërtimin në parcelat (Zonen) ku paraqitjet ndërtimi i ulët me kërkojm qe të na behet e mundësuar ndërtimi i lart. Duke pas paraqyer nevojen per ndërtim e mundësit per investim në ndërtim të lart shpresojmë qe kërkesës na lejohet ndërtimi i lart. Dragash/23-07-2021 Shaban Neziri	Aprovohet	Kërkesa juaj është shqyrtuar dhe aplikuar ne draft-projektin e Hartës Zonale të Komunës së Gllogocit 2021-2029.

7.		**Izet Krasniqi** **Naim Krasniqi** **Uke Krasniqi** **Maliq Krasniqi** **Fehmi Krasniqi** **23.07.2021**	Komuna Drenas (6) Ekipes Komunale të Planifikimit, Kërkesë -Kërkojmë nga ekipa komunale për Planifikim të Hartës zonale që parcelat me numër 00258-02, 00258-03, 00258-04, 00258-05, 00258-06, 00258-07, 00258-08, 00258-09, 00258-10, 00258-11, 00258-12, 00258-13, 00258-14, 00258-15, 00258-16 që të hyjnë në zonën e ndërtimit të mesme në Hartën zonale të komunës së Drenasit, gjëndëll në zonën katastrale Komoran (Qendër). Parcelat e lartëcekura janë në zonën e ndërtimit dhe i plotesojnë të gjitha kriteret për të hyrë në harta zonale për ndertime të mesme. -Mbesimi me shpresë se ne pronarët e këtyre parcelave, se kërkesa e jonë drejtuar juaj do të gjëjë mirëkuptim që të marrë aprovimin e juaj. -Për plotesimin/aprovimin e këtyre kërkesave ju falënderojmë. Paraqitësit e kërkesave: Izet Krasniqi Naim Krasniqi Uke Krasniqi Maliq Krasniqi Fehmi Krasniqi Drenas: 23/07/2021 Nr kontaktues 044/207-397 049/978-808.	Refuzohet	Kërkesa juaj nuk aprovuar. Nuk korrespondon me Normat teknike të Planifikimit Hapësinor.

